




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 2-D/DPK	Nr. Prot. 01-5018/14
Dep. 02	Br. Prot. Prot No.
Nr. i faq. 02	Data 26-12-2014
Broj stranica	Datum
Nr. pages	Date



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.12.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 3766/14, për z. Skender Gjonbalaj – Drejtor i Departamentit të Operimit të Tregut në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut - KOSTT, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-3766/14, për z. Skender Gjonbalaj – Drejtor i Departamentit të Operimit të Tregut në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut - KOSTT, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Në këtë rast zyrtari i lartë z. Gjonbalaj, është hetuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, si zyrtar i lartë në Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Tregut dhe njëkohësisht pronar në biznesit privat “Hartini”.

Zyrtari i lartë fillimisht është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, ndërsa më pas është takuar me zyrtarët e Agjencisë për t’i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj, në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Gjonbalaj është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat dhe ka kërkuar që vullnetarisht ta mbyllë këtë biznes.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 4974/14), me të cilën vërtetohet se ka mbyllur biznesin. Me këtë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

